



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*



**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

**AGJENCIONI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË KOSOVËS/  
INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS**



# BULETINI HIDRO-KLIMATOLOGJIK

**TREMUJORI I DYTË 2016, Nr.2**

**Prishtinë, 2016**

I nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që përmes veb faqes së Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) <http://www.ammk-rks.net/> të ju ofrojmë mundësinë që të keni qasje në informacionet për gjendjen hidrologjike dhe klimatologjike gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016 , të cilat janë dhënë në numrin e dytë të buletinit hidro-klimatologjik. Përgatitja e këtij buletini është kontribut i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës.

Informimi cilësor dhe efikas rreth elementeve dhe dukurive hidrologjike, klimatologjike dhe dukurive ekstreme të motit ka qenë një shtytje që të punohet në publikimin e këtij buletini i cili do të jetë mjet informimi në bazë tremujore.

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është që të sjellim para jush informata të rëndësishme rreth gjendjes hidrologjike , meteorologjike dhe klimatologjike, por edhe të paraqesim, projektet dhe aktivitetet e institutit hidrometeorologjik.

Shpresojmë se ky buletin do të bëhet një burim i rëndësishëm për t'ju ofruar informata të përditësuara dhe interesante rreth gjendjes hidrologjike dhe klimatologjike në Kosovë.

**Dr.sci. Ilir Morina**, Kryeshef Ekzekutiv i  
Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

**Ing/Msc. Letafete Latifi** , Drejtore e Institutit  
Hidrometeorologjik të Kosovës



## PARATHËNJE

Hartimi i Buletinit Hidrologjik dhe Klimatologjik është i bazuar në te dhënat e mbledhura nga monitorimi hidrologjik dhe meteorologjik në Kosovë gjatë periudhes 01 Prill - 30 Qershorë 2016, realizuar nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovë .

Në Buletinin Hidrologjik dhe klimatologjik është pasqyruar gjendja hidrologjike, klimatologjike dhe rastet e paraqitjes së dukurive ekstreme të motit, janë dhënë fakte nga tereni mbi nivelet e ujrave në lumenjtë e Kosovës, sasia e reshjeve dhe indeksi i standardizimit të reshjeve(SPI) si dhe fakte mbi gjendjen klimatike që përfshinë temperaturat mesatare, minimale dhe maksimale të mesatareve mujore , orët me shkëlqim të diellit dhe ditët me reshje shiu gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016. Janë dhënë informacione mbi rastet e paraqitjes së dukurive ekstreme të motit në Kosovë dhe zonat e përfshira me dukuri ekstreme të motit gjatë periudhës për të cilën referohemi në këtë bulletin.

Qellimi i këtij bulletini është që të mbajë të informuar institucionet qeveritare dhe joqeveritare për gjendjen hidrologjike në Kosovë, kushtet klimatike dhe dukuritë ekstreme në mënyrë që institucionet relevante dhe politikëbërësit të orientojnë drejt projektete dhe planet e tyre të veprimit.


## GJENDJA HIDROLOGJIKE NË KOSOVË

Gjendja hidrologjike në Kosovë monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës përmes Rrjetit të Monitorimit Hidrologjik.

Rrjeti i monitorimit hidrologjik në Kosovë, është i dizajnuar në atë mënyrë, që duke u bazuar në karakteristikat e florës, topografisë, relievit, klimës, etj është bërë vendosja e stacioneve hidrometrike, qëllimi i të cilëve është që në hapësirë dhe kohë, të paraqesin treguesit sasiorë, të njërës prej resurseve më të rëndësishme siç është uji. Rrjeti aktual monitorues, përbëhet prej 27 stacioneve hidrometrike (harta1), të cilët janë të shtrirë në të gjitha pellgjet ujëmbledhëse dhe në bazë të lartësisë mbidetare shtrirja e tyre përfshinë nivelet e larta, të mesme dhe ultësirat (grafiku 1).



*Harta1. Rrjeti i stacioneve hidrometrike të Kosovës*



*Grafiku 1. Rrjeti i stacioneve hidrologjike të Kosovës i shtrira sipas lartësisë mbidetare*

Stacioni hidrologjik në Drelaj, në lumin Bistrica e Pejës, aktualisht është i vendosur në lartësinë më të madhe mbidetare në Kosovë, dhe atë në 988 m, ndërsa stacioni i vendosur në lartësinë më të ulët prej 338 m është në Gjonaj në lumin Drini i Bardhë.

**Tabela 1 Nivelet mesatare, maksimale dhe minimale (cm), për periudhën prill, maj, qershorë 2016<sup>1</sup>**

Nr	Kodi	Stacioni	mes. IV-VII	max. IV-VII	min. IV-VII	H_min AP	H_max AP	Data min	Data max
1	RV0101	Berkovë	1.092	1.460	0.910	0.884	1.605	27.06.2016	21.05.2016
2	RV0102	Drelaj	0.781	1.310	0.440	0.356	1.452	30.06.2016	21.05.2016
3	RV0103	Grykë	0.816	1.200	0.580	0.584	1.429	30.06.2016	21.05.2016
4	RV0104	Klinë	0.696	1.090	0.570	0.561	1.255	15.04.2016	21.05.2016
5	RV0105	Mirushë	0.718	0.950	0.620	0.623	0.973	30.06.2016	04.05.2016
6	RV0106	Deçan	0.492	1.200	0.330	0.321	1.407	22.06.2016	21.05.2016
7	RV0107	Këpuz	1.507	2.660	0.940	0.952	2.822	30.06.2016	22.05.2016
8	RV0108	Gjakovë	0.628	1.370	0.360	0.319	1.628	24.06.2016	21.05.2016
9	RV0109	Piranë	1.098	1.410	0.920	0.907	1.515	25.06.2016	04.05.2016
10	RV0110	Gjonaj	5.227	6.350	2.270	2.252	6.383	01.04.2016	14.06.2016
11	RV0111	Prizren*	-	-	-	-	-	-	-
12	RV0112	Vllashnje*	-	-	-	-	-	-	-
13	RV0201	Drenas	1.216	2.240	0.980	0.966	2.278	25.06.2016	04.05.2016
14	RV0202	Lluzhan	0.936	1.640	0.630	0.616	1.675	27.06.2016	05.05.2016
15	RV0203	Nedakovc	1.522	1.980	1.400	1.384	1.999	27.06.2016	06.05.2016
16	RV0204	Vragoli	0.714	1.180	0.540	0.531	1.207	27.06.2016	06.05.2016
17	RV0205	Caraleva	0.239	0.701	0.161	0.161	0.701	29.06.2016	03.05.2016
18	RV0206	Millosev	1.560	2.910	1.080	1.052	2.971	26.06.2016	05.05.2016
19	RV0207	Prelez**	-	-	-	-	-	-	-
20	RV0208	Leposaviç	1.840	2.360	1.510	1.444	2.396	30.06.2016	01.04.2016
21	RV0301	Konqul	2.651	3.920	2.190	2.179	4.127	30.06.2016	04.05.2016
22	RV0302	Domarocv*	-	-	-	-	-	-	-
23	RV0303	Viti	0.718	1.220	0.610	0.573	1.335	30.06.2016	04.05.2016
24	RV0401	Kaçanik	0.441	0.750	0.360	0.348	0.79	22.06.2016	22.05.2016
25	RV0402	Brod	0.810	1.140	0.630	0.628	1.199	30.06.2016	21.05.2016
26	RV0403	Hani Elezit	0.549	0.950	0.360	0.334	1.082	18.06.2016	22.05.2016
27	RV0501	Mlikë	0.842	1.070	0.630	0.390	1.132	27.06.2016	22.05.2016

Nga të dhënat e tabelës (1), vërejmë se të tre muajt karakterizohen me nivele mesatare, të cilat janë në kondita normale duke i krahasuar ato me periudhën e vitit paraprak, por nuk ka devijim të theksuar edhe nga vlerat mesatare shumëvjeçare.

<sup>1</sup> H\_min\_AP dhe h\_max\_AP, parapet nivelin më të lartë të regjistruar gjatë periudhës referuese (IV-VII)

\*Për shkaqe teknike nuk janë llogaritur për këtë periudhë

\*\*Për shkaqe sigurie personeli i sektorit të IHMK nuk ka arritur që ti merr të dhënat për këtë periudhë

Nivelet më të larta janë regjistruar në lumin Drini i Bardhë, stacioni Gjonaj (shih garfikun 2), në të cilin niveli mesatarë maksimal ka qen 522.7 cm, ndërsa ai maksimal absolut gjatë kësaj periudhe ka arritur më datën 14.06.2016, dhe ka pasur vlerë 635.0 cm, ndërsa niveli minimal absolut në po këtë stacion ka qen më datën 01.04.2016, dhe ka pasur vlerën 225.2 cm.


Në stacionet hidrometrike të cilat i përkasin pellgut të Ibrit, (8), e të cilat janë të vendosur nëpër lumenjtë kryesorë (2 në Ibër, 2 në Sitnicë, 2 në Llap dhe nga 1 në Drenicë dhe 1 në Lumin e Caralevës), niveli mesatarë gjatë kësaj periudhe ka qen 114.7 cm, ku niveli më i larti është regjistruar më datën 05.05.2016 në lumin Llap, stacioni Milloshevë dhe ka arritur në 297.1 cm, ndërsa niveli minimal 0.161 cm më datën 29.06.2016, është regjistruar në lumin e Caralevës.

Në pellgun e Moravës së Binçës, jan të vendosura 3 stacione hidrometrike, 2 prej tyre në vetë lumin e Moravës dhe një në atë të Kriva Rekës. Gjatë periudhës IV –VI, niveli më i lartë prej 412.7 cm është regjistruar më datën 04.05.2016, në stacionin e Konçulit, ndërsa ai minimal ka pasur vlerën 0.573, dhe është regjistruar më datën 18.06.2016, në stacionin e Vitisë.

Në pellgun e Lumit Lepenc janë aktive 3 stacione hidrologjike, prej tyre 2 në Lepenc (Brodë dhe Hani Elezit) dhe një në Nerodime në Kaçanik. Në lumin Lepenc niveli më i lartë i regjistruar gjatë kësaj periudhe ka qen 119.9 cm dhe është regjistruar më datën 21.05.2016, ndërsa ai minimal më datën 18.06.2016, dhe ka pasur vlerën 0.334 cm.

Në Lumin e Brodit stacioni në Mlikë, niveli maksimal ka arritur më datën 22.05.2016, dhe ka pasur vlerën 113.2 cm, ndërsa ai minimal ka pasur vlerën 0.390 cm.

**Grafiku 2. Nivelet mesatare gjatë muajve Prill-Maj-Qershorë 2016**



Niveli mesatarë i të gjitha stacioneve gjatë kësaj periudhe ka qen 117.8 cm, niveli mesatarë minimal ka qen 0.827 cm, ndërsa ai mesatarë maksimal 178.5 cm.

Gjendja meteorologjike dhe klimatologjike në Kosovë monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës përmes rrjetit të monitorimit meteorologjik dhe rrjetit për monitorimit e reshjeve (shih hartën 2).

Rrjeti meteorologjik është një numër i integruar i stacioneve matëse i shpërndarë në gjithë territorin e Kosovës ku kryhen matje kualitative dhe të koordinuara mbi specifikat e lokacioneve. Arkivimi i të dhënave meteorologjike bëhet në softuerin qendror (MCH) të IHMK, përmes të cilit bëhet edhe përpunimi i të dhënave.

Analiza e të dhënave të regjistruara në stacionet meteorologjike gjatë periudhës për të cilën i referohemi në këtë buletin na bënë të kuptojmë se çfarë e karakterizon periudhën Prill-Qershor 2016.


**Temperatura e ajrit-** karakterizohet me vlerën e tempertaurës mesatare mujore, mesatares mujore minimale, dhe mesatares mujore të temperaturës maksimale si dhe me numrin e ditëve me vlerën e temperaturës mbi ose nën pragun e përcaktuar ( varësisht nga sezoni dhe klima karakteristike).

Në vazhdim janë dhënë grafikonet e temperaturave karakteristike të ajrit (grafikoni 3 dhe 4) për stacionet kryesore klimatologjike, përfaqësuese të regjionit të rrafshit të Kosovës/pellgut të Ibrit-stc. në Prishtinë , rrafshit të Dukagjinit/Pellgut të Drinit të bardhë-stac. në Pejë dhe Pellgut të Lepencit-stac. në Ferizaj.


Nga analiza e grafikoni 3 vërehet se peiudha 01 Prill- 30Qershor 2016 është karakterizuar me temperaturë të lartë gjatë muajit Prill dhe Qershor krahasuar me temperaturat mesatare mujore të viteve 1960/1990. Temperatura mesatare mujore më e ulët gjatë kësaj periudhe ka qenë 0 °C gjatë muajit Prill, e regjistruar në stacionin e Ferizajit , ndërsa temperatura më e nxehtë dhe karakteristike është regjistruar gjatë muajit maj në stacionin meteorologjik në Prishtinë dhe arrin vlerën në 33.8 °C.



Harta2. Rrjeti i stacioneve meteorologjike




Grafiku 3. Temperatura mesatare mujore në stacionet meteorologjike



Grafiku 4. mesatarja mujore e temperaturës minimale dhe maksimale të ajrit

**Numri i ditëve me temperatura 25°C** - periudha për të cilën jemi referuar në këtë buletin karakterizohet me numrin e ditëve me temperatura >25°C, ku gjatë muajit prill dhe maj në kanë qenë 5 ditë me temperaturë 25°C në Ferizaj, 9 ditë në Prishtinë, dhe 12 ditë në Pejë, ndërsa me temperaturë mbi 30°C kanë qenë 10 ditë në Ferizaj, 10 ditë në Prishtinë dhe 10 ditë në Pejë, por është karakteristike se gjatë muajit prill në stacionin e Ferizajit janë regjistruar 2 ditë me temperaturë negative. Ndërsa për zonën e Ferizajit muaji maj është karakteristik edhe me numrin e ditëve me temperaturë 25°C pasi që gjatë muajit maj nuk është regjistruar asnjë ditë me temperaturë 25 shih graf. 5





*Grafiku5. Numri i ditëve me temperatura  $25^{\circ}\text{C}$  të regjistruara në stacionet klimatologjike*

**Numri i orëve me shkëlqim të diellit-** gjatë periudhës 01 Prill-30 Qershor 2016 në Prishtinë ka pasë 640 h me diell, ndërsa në Ferizaj 583 h.

**Shpejtësia e erës-** Eshte karakteristike se gjate periudhes 01 Prill-30 Qershor janë paraqitë erëra të forta ku shpejtësia maksimale ka arrite ne 18.4 m/sec ne Ferizaj , 18 m/sec në Prishtinë dhe 10 m/sec në Pejë(zonë urbane), si pasoj e fushave ciklonike qe përfshinë vendin tonë.

**Numri i ditëve me reshje bore dhe shiu-** gjatë kësajë periudhe është karakterizuar muaji maj me më së shumti ditë me reshje shiu kështu qe në Pejë janë regjistruar 17 ditë me reshje shiu, në Prishtinë 17 dhe në Ferizaj 12 ditë, ndërsa reshje bore nuk ka pasë.

**Reshjet** – Tremujori i dytë i vitit 2016 karakterizohet me reshje te shumta të shiut sidomos ne muajin maj. Sasia maksimale eshte regjistruar ne Peje me  $116.4\text{mm}(l/m^2)$  gjatë muajit maj, ndërsa sasia totale per kete periudhe ne Peje arrinë në  $176.8\text{mm}(l/m^2)$ , në Prishtinë në  $170.8\text{mm}(l/m^2)$  dhe në Ferizaj në  $200\text{mm}(l/m^2)$ . Sipas shpërndarjes së përqindjes reshjet shkonin në kategorinë e normales dhe vende vende te lagësht (mbi normalen).

## DUKURIT EKSTREME

### PARAQITJA E THATËSIRAVE NË KOSOVË- INDEKSI STANDARD I PRECIPITIMIT(RESHJEVE)-SPI

Situata e thatësirav në lidhje me akumulimin e reshjeve është paraqitur nga Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI). Llogaritja e SPI është e bazuar në shpërndarjen e reshjeve mbi periudha të gjata kohore 30 vjet , ne këtë rastë janë përdorur mesataret afatgjate (1926/1949-2016).

SPI mund të llogaritet në shkallë të ndryshme kohore te cilat pasqyrojnë ndikimin e thatësirës mbi disponueshmërinë e burimeve ujore.

Te dhënat për reshjet e regjistruara për një periudhë të gjatë kohore mundësonë një shpërndarje probabiliteti, e cila është normalizuar më pas në mënyrë që mesatarja SPI për çdo vend dhe periudhë kohore është zero. Vlerat e SPI mbi zero tregojnë periudha me lagështirë dhe vlerat nën zero tregojnë periudha të thata. Në vazhdim janë paraqitë tabelat e SPI për regjionin e rrafshit të Kosovës/pellgu i Ibrit- stac.në Prishtinë, regjionin e Dukagjinit/pellgu i Drinit të Bardhë- stac.në Pejë dhe pellgun e Lepencit-stac. në Ferizaj.

tabela.2. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) per Prishtinë



## PARAQITJA E VËRSHIMEVE NË KOSOVË

Siq është përmend edhe më lartë kjo periudhë është karakterizuar me reshje shiu ne disa raste të shoquara edhe me reshje të breshërit. Reshjet e shiut ishin ne suaza te normales, keshtu qe niveli i ujrave në lumenjtë e Kosovës kishte pësuar ngritje të lehtë por nuk kishte dalje nga shtrati i lumit asnjëherë gjatë tremujorit te dyte të këtijë viti, që d.m.th se gjatë kësajë periudhe nuk ka pasë vërshime.

## **BULETINI HIDRO-KLIMATOLOGJIK- TREMUJORI I DYTË 2016, Nr.2**

### **Publikuar nga:**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës  
Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

**Buletini Hidro-Klimatologjik - tremujori i dytë 2016, nr.2-** Është përgatitur nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës .

### **Përgatitja e buletinit është realizuar nga:**

**Ing.e dipl./Msc. Letafete LATIFI**, *Drjetore e IHMK;*  
**Dr.sci. Bashkim KASTRATI**, *Hidrolog i lartë ne IHMK;*  
**Msc. Besim ALIU**, *Meteorolog në IHMK, stc.në Ferizaj.*

### **Kontribues në përgatitjen e buletinit janë zyrtarët e hidrologjisë dhe meteorologjisë:**

**Xhevahire Puraj**, *Hidrologe;*  
**Ing i dipl./Msc. Hasan Hasani**, *Hidrolog i lartë;*  
**Faton Sopi**, *Administrator në databazë;*  
**Beqir Gashi** , *Meteorolog, stac. Në Prishtinë*  
**Bardhyl Ahmetxhekaj**,*Meteorolog, stc.në Pejë*